

VENDIM
Nr. 175, datë 18.5.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.5.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/1 prot., datë 17.5.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1379 prot., datë 8.5.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b” dhe “d” dhe për pikën 1.3, gerrat “a” dhe “b”.

- Shoqëria duhet të depozitojë në ERE në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin:

- strukturën organizative;
- informacion mbi sasinë e energjisë elektrike (në gwh) të parashikuar për t’u tregtuar gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës;

- planin e biznesit.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të Rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi